



AVOKAT – LAWYER  
**Besnik R. BERISHA**

Rr / Str. Luan Haradinaj 21/2, 10000 Prishtinë  
Republika e Kosovës / Republic of Kosovo  
E- mail: [besnik.berisha@yahoo.com](mailto:besnik.berisha@yahoo.com)  
Tel & Fax: +381 (0) 38 220 562  
Mobil: +377 (0) 44 151 402

**PP. I. nr. 58/23**

**DREJTUAR:** z. Besim KELMENDI,  
UD. i Kryeprokurorit të Shtetit

**PËR DIJENI:** z. Jetish MALOKU,  
Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës

**OBJEKTI:** I. Kërkesë urgjente për marrjen nën juridiksion  
të çështjes penale PP. I. nr. 58/23  
II. Kërkesë për vlerësimin e ligjshmërisë dhe  
kushtetutshmërisë së veprimeve procedurale  
të kryera nga prokurori Rasim Maloku

**BAZA LIGJORE:** Ligji Nr. 08/L-167 për Prokurorin e Shtetit  
Neni 20.3

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 29

I nderuar z. Besim KELMENDI,

1. Në cilësinë e qytetarit të Republikës së Kosovës, viktimë e një procesi hetimor të montuar, një arrestimi arbitrar dhe të kundërligjshëm, si dhe të krimeve të bëra nga prokurori Rasim Maloku, prokuror pranë Prokurorisë Themelore në Ferizaj, duke vepruar në mbrojtje të së drejtës për liri dhe siguri, të garantuar me nenin 29 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe mbështetur në nenin 20.3 të Ligjit Nr. 08/L-167 për Prokurorin e Shtetit, me respekt ju drejtohem për të marrë nën juridiksionin tuaj çështjen penale PP. I. nr. 58/23 kundër meje, si dhe për të themeluar një ekip prokurorësh dhe ekspertësh për të vlerësuar ligjshmërinë dhe kushtetutshmërinë e veprimeve procedurale të kryera nga prokurori Rasim Maloku.

2. Përpara elaborimit të pretendimeve që mbështesin kërkesën, ju siguroj se qëllimi i të njëjtës nuk është trajtimi i privilegjuar, apo përfitimi i kundërligjshëm i ndonjë përparësie që nuk më takon, por sigurimi efektiv i trajtimit të barabartë dhe pa paragjykime, si dhe respektimi efektiv i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të përcaktuara me Kushtetutë, legjislacionin në fuqi dhe konventa ndërkombëtare, përkatësisht zhvillimi i një hetimi të pavarur dhe objektiv, siç garantohet me dispozitat e KPPRK.
3. Gjithashtu, theksoj se çdo pretendim i elaboruar në këtë kërkesë bazohet mbi bindjen time personale, ndërsa parashtrimet bëhen në rrafshin personal dhe bazohen mbi përjetimet e mia me rastin e arrestimit tim, bastisjes së njëres prej pronave të mia, si dhe paraqitjen e kërkesës për paraburgim.
4. **Ashtu siç tashmë kam denoncuar edhe publikisht, me këtë parashtrësë denoncoj veprimet arbitrare dhe të kundërligjshme, gjegjësisht krimet e kryera nga prokurori Rasim Maloku, i cili, duke iu servilosur urdhrave të pushtetit, të dhëna nga një ministre e Drejtësisë dhe jo vetëm, të cilën unë e kam kritikuar publikisht për paditurinë, dështimet dhe paaftësinë e saj profesionale, më datë 13.07.2023, duke shpërfillur dhe shkelur çdo garanci ligjore nga neni 33.1 i Ligjit Nr. 04/L-193 për Avokatinë urdhëroi arrestimin tim, duke abuzuar haptazi dhe qëllimshëm me autorizimet e tij zyrtare.**
5. **Arrestimi im arbitrar dhe i kundërligjshëm, si dhe kërkesa për caktimin e paraburgimit, e datës 14.07.2023, reflektojnë hakmarrjen e paskrupullt dhe meskine të pushtetit të instaluar në vend, përmes veglës/mashës së tij, prokurorit Rasim Maloku, abuzimin me pushtetin prokurorial dhe persekutimin në emër të drejtësisë.**
6. **Këto veprime arbitrare, të kundërligjshme dhe të papranueshme përbëjnë një sulm të paprecedent kundër meje personalisht, si dhe kundër vlerave dhe vetë profesionit të lirë dhe të pavarur të avokatisë.**
7. **Për më tepër, amnistimi eventual i të tilla veprimeve arbitrare dhe të kundërligjshme minon sigurinë juridike të çdo qytetari të Republikës, si dhe instalon frikën, terrorin dhe nënshtrimin përpara pushtetit, i cili shërbehet me mashat e tij, siç është prokurori Rasim Maloku.**
8. **Ashtu siç është argumentuar fuqishëm gjatë seancës dëgjimore të datës 14.07.2023, e cila zgjati plot 10 orë, kërkesa për caktimin e paraburgimit përmban gënjeshtër të kulluara, shtrembërime të qëllimshme të fakteve, trillime dhe sajesa inkriminuese që nuk gjejnë asnjë mbështetje në deklaratat e dëshmitarëve, por janë rezultat i hakmarrjes së paskrupullt dhe meskine të prokurorit të çështjes Rasim Maloku, i cili urdhëroi arrestimin tim, duke abuzuar haptazi dhe qëllimshëm me autorizimet e tij zyrtare.**
9. Në vijim të kësaj kërkesë ju do të gjeni të gjitha argumentet që provojnë manipulimet me prova, gënjeshtër, trillimet dhe mashtrimet e prokurorit Rasim Maloku, të cilat i njëjti i ka jetësuar me qëllimin për të më dëmtuar, njollosur dhe diskredituar publikisht.



### **Rrjedha procedurale:**

10. Më datë 13.07.2023, ora 6.10 minuta të mëngjesit, kundërligjshëm jam arrestuar dhe privuar nga liria, për shkak të dyshimit të bazuar se kinse kam kryer veprat penale *Ushtrimi i ndikimit*, të sanksionuar nga neni 424 i KPRK, *Dhënia e ndihmës kryesve pas kryerjes së veprave penale*, të sanksionuar nga neni 380 i KPRK dhe *Pengimi i të provuarit, apo procedurës zyrtare*, të sanksionuar nga neni 386.1, nënpar. 1.3 i KPRK.
11. Arrestimi im ka qenë tërësisht arbitrar dhe i kundërligjshëm, sepse i njëjti ka ndodhur vetëm me urdhër të prokurorit Rasim Maloku, por jo edhe me urdhër të Gjykatës, siç parashihet me nenin 33.1 të Ligjit Nr. 04/L-193 për Avokatinë.
12. Më datë 14.07.2023, me fillim nga ora 19.30, pranë Klinikës së Kardiologjisë në Prishtinë-SHSKUK është mbajtur seanca dëgjimore për caktimin e masës së paraburgimit, sipas Kërkesës së Prokurorisë, të paraqitur më datë 14.07.2023, seancë e cila ka zgjatur deri në ora 5 të mëngjesit, të datës 15.07.2023.
13. Më datë 16.07.2023, GJPP ka marrë aktvendim, me të cilin Gjykata caktoi masën e ndalimit për t'iu afruar në distancë prej 50m personave Gëzim Sinani, Salih Sinani, Kajtaz Sinani, Shefik Rexhepi, si dhe personave të tjerë të përfshirë në aktvendimin për fillimin e hetimeve, deri më datë 12.08.2023.

### **Konteksti faktik që i parapriu arrestimit:**

14. Përpara elaborimit të pretendimeve që mbështesin kërkesën, është esenciale që fillimisht të përshkruaj, qoftë edhe shkurtimisht, kontekstin faktik që i parapriu arrestimit tim.
15. Konfliktet verbale me prokurorin e çështjes Rasim Maloku, në suazat e ushtrimit të profesionit, kanë filluar para 6-7 vjetësh, me ç'rast prokurori në fjalë, akoma pa më njohur profesionalisht, detyronte klientin tim që të pranonte se zëri në një audio incizim të servuar nga prokurori, ishte i klientit, çka nuk ishte e vërtetë dhe në fund rezultoi me lirin e klientit nga akuzat (rasti Valon Demukaj).
16. Një tjetër konflikt verbal, në suazat e ushtrimit të profesionit, ka ndodhur më datë 26.04.2022 me rastin e marrjes në pyetje të të dyshuarit Arben ÇITAKU, ku i njëjti prokuror ia mohoi të mbrojturit nga unë ushtrimin efikas të së drejtës për t'u këshilluar me mbrojtësin para dhe gjatë marrjes në pyetje, duke ndërprerë marrjen në pyetje, si dhe duke lëshuar një njoftim për media lidhur me ndërprerjen, që përbënte një precedent të padëgjuar ndonjëherë, sepse sot në praktikë ndërprehen me qindra marrje në pyetje, por kjo nuk përbën lajm relevant për njoftim për media.
17. Vlen të theksohet këtu se pas ndërprerjes së marrjes në pyetje, më datë 26.04.2022, z. Arben ÇITAKU është kushtëzuar/shantazhuar nga prokurori Rasim Maloku, përmes Av. Ridvan Kajtazi, se përsëritja e dhënies së deklaratës do të kishte qenë e mundur vetëm nëse unë nuk do të kisha qenë mbrojtës i tij dhe se avokat mbrojtës do të kishte qenë Ridvan Kajtazi, me çka ka privuar z. Arben ÇITAKU nga e drejta themelore për t'u mbrojtur nga mbrojtësi sipas zgjedhjes së tij të lirë.



18. Përgjatë gjithë kësaj kohe unë kam qenë shumë i zëshëm në rrjete sociale, duke denoncuar dukuri për bindjen time tejet negative që karakterizojnë punën e prokurorisë, si dhe duke kritikuar edhe regjimin autoritar të instaluar nga pushteti aktual.
19. Denoncimet e fundit kishin të bënin me embargon e armëve karshi Kosovës, si dhe çështjen e ligjshmërisë së përgjimeve në skandalin që përfshinte shefen e grupit parlamentar të VV Mimoza Kusari Lila me shefin e grupit parlamentar të Listës Serbe Sllavko Simic, me ç'rast kritikoja qëndrimin e ministres së Drejtësisë lidhur me përgjimet në fjalë, duke vënë në pah paaftësinë e saj profesionale, të cilën e ka dëshmuar në shumë raste.
20. Vetëm një ditë pas këtyre denoncimeve dhe kritikave, prokurori i çështjes, edhe pse nuk kishte urdhëresë për bastisjen e njërën prej pronave të mia që gjendet tek Fshati Ndërkombëtar, mëngjesin e hershëm të datës 13 korrik 2023, me forca të shumta speciale, rrethoi njërën nga pronat e mia, duke terrorizuar banorët, të cilët kujtuan se po zhvillohej operacion policie kundër një kriminelit të rrezikshëm dhe të shumëkërkuar.
21. Në të gjitha lajmet e datës 13.07.2023 pa bërë asnjë krim, vetëm për shkak të profesionit e të hakmarrjes së paskrupullt dhe meskine të prokurorit Rasim Maloku, ndonëse nuk ekzistonte asnjë provë, jam portretizuar si sekser, edhe pse në karrierën time kam shënuar plot suksese dhe fitore, jo duke blerë drejtësi, por duke i shërbyer gjyqësisë.
22. Një arrestim i tillë, i bërë sa për të shkaktuar bujë mediatike dhe për të njollosur dinjitetin dhe reputacionin tim, jo vetëm që ka qenë i kundërligjshëm, por ka ndodhur në shenjë hakmarrje të paskrupullt dhe meskine të prokurorit Rasim Maloku kundër meje.

### **Kundërligjshmëria e arrestimit:**

23. **Ju garantoj se arrestimi im më datë 13.07.2023 ka qenë tërësisht i kundërligjshëm dhe haptazi arbitrar, sepse i njëjti, edhe pse dyshimet ndërlidheshin me vepra në kuadër të ushtrimit të profesionit, nuk është urdhëruar nga Gjykata kompetente, siç parashihet shprehimisht me nenin 33.1 të Ligjit Nr. 04/L-193 për Avokatinë, por është autorizuar nga prokurori i çështjes Rasim Maloku, i cili, i prirur nga meskiniteti dhe qëllimi për hakmarrje të paskrupullt kundër meje, abuzoi me kompetencat e tij, duke urdhëruar ndalimin tim për 48 orë.**
24. Siç jeni në dijeni, neni 33.1 i Ligjit Nr. 04/L-193 për Avokatinë përbën dispozitë ligjore tejet të rëndësishme, sepse mbron avokatët nga arbitrariteti i kundërligjshëm në rastet kur synohet të sulmohet puna e tyre profesionale në mbrojtje të të drejtave dhe interesave ligjore të klientëve të tyre.
25. Duke njohur mundësinë e keqpërdorimit të vendimit për arrestim/ndalim për 48 orë, Ligji për Avokatinë, si ligj special, i cili derogon dispozitat e përgjithshme procedurale të KPPRK, kërkon vendim të gjykatës për privimin nga liria të avokatit në këto raste. Pa këtë mbrojtje ligjore nga arbitrariteti është e pamundur të ushtrohet në mënyrë të mirëfilltë, të pavarur dhe efikase profesioni i avokatit.



26. Me rastin e arrestimit tim mëngjesin e hershëm të datës 13.07.2023 dhe përgjatë gjithë ditës, ende pa u kryer marrja në pyetje, prokurori Rasim Maloku, kur unë e pyesja se çfarë krimi kam bërë, i njëjti përsëriste fjalët “*Këto ia tregon gjyqtarit*”, nga ku rezulton se i njëjti, i bindur se unë do t’i nënshtrohesha veprimeve të tij të kundërligjshme, tashmë kishte vendosur rrugën që do të ndiqte.
27. Në anën tjetër, për arrestimin tim nuk plotësohej asnjë kusht ligjor dhe as ekzistonin kushtet e flagrancës, pra spektakli mediatik i datës 13 korrik 2023 ishte tërësisht i evitueshëm, që mund të menaxhohej përmes thirrjes time të rregullt për t’u marrë në pyetje nga prokurori, apo policia, lidhur me dyshimet që rëndonin mbi mua.
28. Për më tepër, me rastin e arrestimit, as policia që kryente operacionin dhe as vetë prokurori Rasim Maloku, i cili ishte personalisht i pranishëm, nuk më informuan për të drejtat nga nenet 13.1 dhe 165 të KPPRK.
29. Duhet theksuar këtu, se hetimi kundër meje ka filluar më datë 06.07.2023 dhe se deri më datë 12.07.2023, ditë në të cilën ka dorëzuar kërkesën për urdhërkontroll, prokurori Rasim Maloku nuk ka kryer asnjë veprim hetimor kundër meje.
30. Data e paraqitjes së kërkesës për urdhërkontroll, pra data 12.07.2023 korrespondon me datën e prononcimeve të mia publike në Rubikon, kundër embargos së armëve, me të cilën është sanksionuar Kosova së fundmi.
31. Më datë 13.07.2023, forca të shumta speciale të Policisë rrethuan njërën nga pronat e mia, duke më privuar kundërligjshëm nga liria.
32. Me qëllim të sqarimit të dyshimeve që rëndonin mbi mua, si dhe demantimit të manipulimeve, gënjeshtreve të paskrupullta, mashtrimeve, trillimeve dhe fabrikimeve të përshkruara në kërkesën për caktimin e paraburgimit nga vetë prokurori Rasim Maloku, gjatë seancës dëgjimore të datës 14.07.2023 kam paraqitur një sërë provash, të cilat rrëzojnë në tërësi trillimet, manipulimet dhe fabrikimet e paskrupullta dhe meskine të prokurorit të çështjes, të cilat do t’i përshkruaj në vijim.

**Trillimi se kinse nuk kam pasur autorizim për të mbrojtur të dyshuarin Gëzim Sinani:**

33. **Gjatë seancës dëgjimore të datës 14.07.2023 kam argumentuar me prova kredibile, të pakontestueshme dhe me vlerë provuese të fuqishme se unë kisha autorizim për të vepruar si avokat mbrojtës i të dyshuarit Gëzim Sinani dhe se pretendimi i prokurorit të çështjes se kinse nuk kam pasur autorizim për të mbrojtur të dyshuarin Gëzim Sinani ishte veç një trillim dashakeq dhe i qëllimshëm i tij.**
34. Në veçanti, gjatë seancës në fjalë, kam parashtruar se në rastin e Gëzim Sinanit jam ftuar nga miku im i ngushtë Valon Ademi, me kërkesën e bashkëshortes së Gëzim Sinanit që në momentin e arrestimit të të njëjtit dhe bastisjes.
35. Prokurori Rasim Maloku as që e ka marrë mundin që të ftonte dhe dëgjonte si dëshmitar Valon Ademin, përpara se të vendoste për ndalimin dhe arrestimin tim.



36. Miku im i ngushtë Valon Ademi, me kërkesën e Kajtazit, prindit të Gëzimit dhe të vetë Gëzimit ka kërkuar që unë të shkoj në Qendrën e Ndalimit policor në Prishtinë për ta vizituar të ndaluarin Gëzim Sinani.
37. **Me atë rast Gëzim Sinani ka konfirmuar autorizimin e dhënë nga babai i tij Kajtazi, duke nënshkruar një tjetër autorizim, me të cilin unë angazhohesha në cilësinë e avokatit të tij mbrojtës.**
38. Autorizimi që më është dhënë me shkrim nga Gëzim Sinani gjendet në dosjen e personit të ndaluar, ndërsa prokurori Rasim Maloku ka qenë në dijeni për këtë dokument.
39. Ndërkohë, nuk ka logjikë të shëndoshë dhe etikë profesionale që si avokat të lejon të shkosh të vizitosh një të ndaluar në Polici pa autorizimin e tij, ose të familjarit të tij, marrë parasysh që në qendrën e ndalimit monitorohet çdo hyrje dhe evidentohet çdo vizitë avokatëve.
40. Është absurde dhe kriminale të mendosh diçka të tillë, lëre më ta shkruash, siç ka vepruar prokurori i çështjes Rasim Maloku.
41. Kajtaz Sinani dhe Gëzim Sinani pohojnë që unë kam qenë mbrojtës i këtij të fundit që në ditën e arrestimit të tij, pra që më datë 21.09.2022.
42. Në mbështetje të të provuarit të ekzistencës së autorizimit për të qenë mbrojtës i të dyshuarit Gëzim Sinani, gjatë seancës dëgjimore të datës 14.07.2023 kam dorëzuar si provë bisedën në mes të Valon Ademit dhe Kajtaz Sinanit, të evidentuar si prova nr. 1, e cila tashmë gjendet në shkresat e lëndës, të cilën prokurori Rasim Maloku ka refuzuar që ta marrë si provë, me arsyetimin se nuk ishte i interesuar për letra dashurie (sic!).
43. Më datë 21 shtator 2022, kur është arrestuar Gëzim Sinani unë kisha kërkesa të vazhdueshme për ta vizituar dhe meqenëse atë ditë gjendesha në Prizren në një seancë gjyqësore, kam dërguar Av. Nora Grajçevci Mehmeti, avokate që punon pranë zyrës time, për ta vizituar të dyshuarin Gëzim Sinani në Qendrën e ndalimit.
44. Më tej, ndryshe nga siç trillon prokurori i çështjes, mospjesëmarrja ime në seancën e paraburgimit, që u mbajt më datë 22 shtator 2022, nuk erdhi si pasojë e vetëdijes time se kundërligjshëm do të përjashtohesha nga çështja, por sepse atë ditë unë duhet të shkoja për ngushëllime në Isniq. Kjo u vërtetua me audioincizimin e bisedës mes meje dhe vajzës time Av. Erina BERISHA, të cilës i kam kërkuar që të koordinohet me kolegen Av. Nora Grajçevci Mehmeti për të prezantuar në seancë, të cilën po ashtu e kam dorëzuar si provë në Gjykatë.

**Trillimi se kinse në të njëjtën çështje penale kam qenë duke e mbrojtur një të pandehur tjetër:**

45. **Gjatë seancës dëgjimore të datës 14.07.2023 kam argumentuar me prova kredibile, të pakontestueshme dhe me vlerë provuese të fuqishme se në të njëjtën çështje penale të të dyshuarve Gëzim dhe Salih Sinani, me numër PP.I. nr. 58/22, unë nuk kam qenë asnjëherë i angazhuar si avokat mbrojtës i ndonjë tjetër të pandehuri dhe se pretendimi i prokurorit të çështjes se kinse në të njëjtën çështje penale kam qenë duke e mbrojtur një të pandehur tjetër ishte veç një trillim dashakeq dhe i qëllimshëm i tij.**



46. Gjatë seancës dëgjimore të datës 14.07.2023 u provua se çështja penale kundër të pandehurve Gëzim dhe Salih Sinani mban numrin PP. I. nr. 58/22 dhe se unë nuk kam qenë i angazhuar si avokat në çështjen në fjalë, deri në momentin e dhënies së autorizimit nga babai i të dyshuarit Gëzim Sinani, më pas të konfirmuar me shkrim nga ky i fundit.
47. Nga ai moment, unë kam qenë avokat mbrojtës i të dyshuarit Gëzim Sinani, në kuadër të çështjes penale PP.I. nr. 58/22.
48. Pretendimi i prokurorit të çështjes Rasim Maloku, se unë kinse në të njëjtën çështje penale kam qenë duke e mbrojtur të pandehurin Arben ÇITAKU përbën një gënjeshtër të kulluar dhe mashtrim të Gjykatës, sepse çështja penale në të cilën unë kam mbrojtur z. Arben ÇITAKU mban numrin PP. I. nr. 138/20.
49. Pra, çështja penale PP. I. nr. 58/22 kundër të dyshuarit Gëzim Sinani dhe çështja penale PP. I. 138/20 në të cilën unë kam mbrojtur z. Arben ÇITAKU përbëjnë dy çështje penale të ndara, për të cilat nuk vlen ndalesa nga neni 54.1 i KPPRK.
50. Nga këto dy çështje kanë derivuar veprime procedurale të ndara, të cilat janë evidentuar me numrat përkatës po ashtu të ndarë dhe të dallueshëm nga njëri tjetri.
51. Për pasojë, çështja penale me numër PP. I. nr. 58/22 kundër të dyshuarit Gëzim Sinani nuk ka të njëjtin identitet procedural me çështjen penale PP. I. 138/20 në të cilën unë kam mbrojtur z. Arben ÇITAKU.
52. Më tej, nga data 30.06.2022, z. Arben ÇITAKU ka autorizuar Av. Ridvan Kajtazi për ta mbrojtur në çështjen penale PP. I. 138/20, ku autorizimi në fjalë i është përcjellë prokurorit Rasim Maloku përmes shkresës nr. Ref. 2021/298260, dt. 01.07.2022.
53. Pra, unë që nga data 30.06.2022 nuk isha më i angazhuar si avokat mbrojtës në çështjen penale PP. I. 138/20 kundër z. Arben ÇITAKU.
54. Autorizimi që më është dhënë nga Kajtaz Sinani, i konfirmuar nga Gëzim Sinani, në çështjen penale PP. I. nr. 58/22, mban datën 21.09.2022, pra tre muaj pas revokimit të autorizimit nga z. Arben ÇITAKU në çështjen penale PP. I. 138/20.
55. Prokurori Rasim Maloku ka qenë i vetëdijshëm për angazhimet specifike të theksuara më lart, por përmes këtij trillimi, qëllimisht ka sjellë në lajthim Gjykatën Themelore në Ferizaj, duke përshkruar në kërkesën për paraburgim një situatë tejet të ndryshme faktike, për të cilën ai ka qenë në dijeni se ka qenë shumë më ndryshe nga ajo e përshkruar, nga ku rezulton qëllimi i tij hakmarrës në mënyrë tejet të paskrupullt.
56. Për pasojë, pretendimi i prokurorisë se unë kam mbrojtur një tjetër të pandehur në çështjen penale PP. I. nr. 58/22 është një gënjeshtër e kulluar, trillim i prokurorit Rasim Maloku dhe mashtrim i hapur i tij në raport me Gjykatën.
57. Në datën e angazhimit në çështjen penale PP. I. nr. 58/22 si avokat mbrojtës i të dyshuarit Gëzim Sinani, pra më datë 21.09.2022, unë nuk kam pasur asnjë pengesë ligjore për të qenë avokat mbrojtës i tij, por edhe nëse do të kishte ekzistuar ndonjë pengesë ligjore, përjashtimi nga lënda është kompetencë ekskluzive e gjyqtarit të çështjes dhe jo e prokurorit.



**Prezantimi i fakteve të rreme që rezultuan në refuzimin e vizitës së datës 22.12.2022:**

58. Gjatë seancës dëgjimore të datës 14.07.2023 kam argumentuar me prova kredibile, të pakontestueshme dhe me vlerë provuese të fuqishme se refuzimi i vizitës së datës 22.12.2022 në Qendrën e Paraburgimit për të dyshuarin Gëzim Sinani kishte ardhur si pasojë e mashtrimit që prokurori Rasim Maloku kishte ushtruar karshi GJPP kompetent pranë Gjykatës Themelore në Pejë.
59. Ky mashtrim është jetësuar nga prokurori i çështjes Rasim Maloku, sepse i njëjti i ka prezantuar GJPP prova të rrejshme, përmes të cilave ka sjellë në lajthim GJPP, duke keqpërdorur autorizimin e dhënë nga i dyshuari Arben ÇITAKU në kuadër të çështjes penale PP.I. nr. 138/20 dhe duke ia prezantuar rrejshëm GJPP në Pejë se ky autorizim kinse është deponuar në çështjen penale PP.I. 58/22 kundër të dyshuarit Gëzim Sinani.
60. Prokurori i çështjes Rasim Maloku, qëllimisht dhe rrejshëm i ka prezantuar GJPP autorizimin e dhënë nga i dyshuari Arben ÇITAKU në kuadër të çështjes penale PP.I. nr. 138/20, në mënyrë që të më pamundësonte që të angazhohesha si avokat mbrojtës në çështjen PP.I. 58/22 kundër të dyshuarit Gëzim Sinani.

**Inkriminimi arbitrar i udhëzimit për të mos pranuar fajësinë dhe për të mos u deklaruar:**

61. Gjatë seancës dëgjimore të datës 14.07.2023 kam argumentuar me prova kredibile, të pakontestueshme dhe me vlerë provuese të fuqishme se udhëzimi i të pandehurve Gëzim dhe Salih Sinani për të mos pranuar fajësinë jo vetëm që nuk përbën krim, por përkundrazi është obligim profesional i çdo avokati, konform nenit 12 të Ligjit Nr. 04/L-193 për Avokatinë:

*Avokati është i detyruar:*

*1.1. të ofrojë ndihmën juridike në mënyrë profesionale, të ndërgjegjshme, te denjë dhe në pajtim me këtë ligj, Statutin dhe Kodin;*

*1.2. të ruajë fshehtësinë e të dhënave, fakteve dhe informatave që i janë dhënë gjatë përfaqësimit të klientëve.*

62. Për këtë qëllim, GJPP i janë dorëzuar në cilësinë e provave materiale korrespondenca në mes të bashkëshortes së të dyshuarit Gëzim Sinani dhe Av. Erina BERISHA, e cila fillon nga data 23.09.2022, deri më datë 13.11.2022, e evidentuar si prova nr. 5, korrespondenca në mes të gruas së të dyshuarit Sali Sinani dhe Av. Dafina Osmani, dt. 08.12.2022, e evidentuar si prova nr. 6, si dhe bisedat në grupin \$hatapp, për rastin Sinani, ku unë si koordinator i grupit jap instruksione për avokatët e grupit sesi duhet të përgatiten në mbrojtjen dhe përfaqësimin sa më profesional të klientëve, e evidentuar si prova nr. 8.



**Trillimi i përmbajtjes së bisedës me të dyshuarit Gëzim dhe Salih Sinani në Gjykatën Themelore në Pejë:**

63. Gjatë seancës dëgjimore të datës 14.07.2023 kam argumentuar me prova kredibile, të pakontestueshme dhe me vlerë provuese të fuqishme se pretendimi i prokurorit Rasim Maloku, se kinse unë, pa autorizim kam biseduar me të pandehurit Gëzim dhe Salih Sinani, të cilëve iu ka thënë “ju ka bërë të fala Shefiku”, duke i udhëzuar të mos deklarohen për të pandehurin Shefik, i cili në bashkëkryerje me të pandehurin Gëzim Sinani ishin të dyshuar se kanë kryer veprën penale të Fajdes, është një gënjeshtër e kulluar, çka përbën krim dhe abuzim të pastër me autorizimet e tij zyrtare.
64. E vetmja provë mbi të cilën prokurori i çështjes mbështet pretendimet e tij është shënimi zyrtar që i njëjti, me dorën e vet, ka përpiluar dhe përfshirë në dosjen e lëndës, pra në një farë forme prokurori, përmes shënimit në fjalë, është shndërrohet në dëshmitar të vetvetes.
65. Në kërkesën për caktimin e paraburgimit prokurori Rasim Maloku trillon se unë kinse u kam thënë të dyshuarve Gëzim dhe Salih Sinani “ju ka bërë të fala Shefiku”, duke interpretuar këtë mesazh si kërkesë për të mos përmendur personin me emër Shefik Rexhepi, edhe pse në po të njëjtin shënim, vetë prokurori Rasim Maloku mohon të ketë dëgjuar diçka të tillë, çka në vetvete përbën trillim mbi trillim.
66. Gjatë seancës dëgjimore është provuar se unë nuk kisha asnjë lidhje me trillimet e prokurorit Rasim Maloku.
67. Me rastin e mbajtjes së seancës për ngrirjen e përkohshme të aseteve unë fare nuk u kam thënë të dyshuarve Gëzim dhe Salih Sinani fjalët që trillon prokurori Rasim Maloku, të cilat i ka inkorporuar në kërkesën për paraburgim, por që vetë i mohon një shënimin zyrtar.
68. Për më tepër, Kajtaz Sinani, babai i të dyshuarve Gëzim dhe Salih Sinani, ka folur me Av. Dafina Osmani në oborrin e Gjykatës Themelore në Pejë, ku kjo e fundit është avokate mbrojtëse e të pandehurit Salih Sinani.
69. Por, edhe nën prezumimin se Kajtaz Sinani do të kishte folur me mua në oborrin e Gjykatës, kjo assesi nuk duhet konsideruar e kundërligjshme, sepse asnjë ligj nuk sanksionon bisedën me personin tjetër.
70. Prokurori i çështjes nuk ka paraqitur në seancë asnjë provë të vetme materiale mbi natyrën dhe përmbajtjen e bisedës në fjalë, të cilën arbitrarisht dhe në mënyrë padëgjuar më parë e konsideron si krim.



## Inkriminimi arbitrar i dhënies së ndihmës juridike si pengim i të provuarit:

71. **Parashtroj se cilësimi arbitrar dhe absurd i dhënies së ndihmës juridike si pengim i të provuarit, apo procedurës zyrtare, përbën këmbanë alarmi për mbarë komunitetin e avokatëve, të cilët një ditë mund të arrestohen dhe akuzohen se kanë penguar procedurën penale si pasojë e dhënies së ndihmës juridike, çka seriozisht cenon sigurinë e tyre juridike, si dhe pavarësinë e vetë profesionit.**
72. Gjatë seancës dëgjimore të datës 14.07.2023 unë kam provuar se kisha autorizim nga Kajtaz Sinani, babai i të dyshuarit Gëzim Sinani, për të vepruar si avokat mbrojtës në kuadër të çështjes penale PP.I. nr. 58/22, autorizim i cili më pas është konfirmuar edhe nga vetë Gëzim Sinani.
73. Njëkohësisht, Av. Dafina Osmani, kolege në zyrën time të avokatisë, ka vepruar si avokate mbrojtëse e të dyshuarit Salih Sinani.
74. Në mbrojtjen dhe përfaqësimin e rastit të vëllezërve Sinani janë angazhuar Av. Nora Grajçevci-Mehmeti dhe Av. Erina Berisha, të dyja avokate pranë zyrës time të avokatisë.
75. Ashtu siç u theksua edhe më lart, udhëzimi për të mos pranuar fajësinë dhe për t'u mbrojtur në heshtje përbëjnë të drejta procedurale për të pandehurit, madje Gjykata është proceduralisht e detyruar që të personat e pandehur në një procedurë penale t'i njoftojë për këto të drejta dhe të kujdeset për zbatimin efikas të tyre.
76. Në anën tjetër, udhëzimi për të mos pranuar fajësinë dhe për t'u mbrojtur në heshtje jo vetëm që nuk përbën krim, siç pretendon prokurori i çështjes, por përkundrazi është obligim profesional i çdo avokati, konform nenit 12 të Ligjit Nr. 04/L-193 për Avokatinë.
77. Për pasojë, ofrimi i ndihmës juridike në mënyrë profesionale, të ndërgjegjshme, të denjë dhe në pajtim me Ligjin për Avokatinë, Statutin e OAK dhe Kodin e Etikës assesi nuk duhet të konsiderohen veprime kriminale në drejtim të parandalimit të të pandehurve në dhënien e informacioneve zyrtarëve policorë dhe prokurorit lidhur me kryerjen e veprës penale, që supozohet të jetë kryer nga të dyshuarit.
78. Një përshkrim i tillë faktik, i ndërtuar nga prokurori i çështjes bazuar në gënjeshtër, trillime dhe mashtrime përbën një *vulnus* për pavarësinë, nderin, dinjitetin dhe prestigjin e profesionit të avokatit.
79. Për më tepër, njoftimi i klientëve mbi lartësinë e sanksionit penal që i kanoset nga pranimi eventual i fajësisë assesi nuk përbën kërcënim të të njëjtëve, por korrektësi profesionale në raport me të njëjtët.
80. Duhet theksuar këtu se prokurori Rasim Maloku i ka parashtruar pyetje Gëzim Sinanit, të cilat cenojnë fshehtësinë e komunikimit avokat-klient, që mbrohet me Kushtetutë dhe ligj, duke kërkuar informata për detajet e këtyre bisedave konfidenciale.
81. Në po të njëjtën mënyrë, gjatë seancës dëgjimore të datës 14.07.2023, prokurori i çështjes nuk arriti që të provojë asnjë element të detyrimit, apo rryshfetit, si mjete të kryerjes së veprës penale *Pengimi i të provuarit, apo procedurës zyrtare*, të sanksionuar nga neni 386.1, nënpar. 1.3 i KPRK.



### Keqpërdorimi dhe tejkalimi i autorizimeve lidhur me bastisjen:

82. **Parashtraj se prokurori Rasim Maloku ka keqpërdorur dhe tejkaluar kompetencat e tij me rastin e bastisjes së njëres prej pronave të mia, gjatë së cilës ishte personalisht i pranishëm.**
83. Së pari, prokurori Rasim Maloku ka përpiluar dhe paraqitur pranë Gjykatës Themelore në Ferizaj kërkesë për bastisje të zyrës time pa shkak ligjor, pra pa disponuar me asnjë provë të vetme kundër meje, për çka Gjykatës i ka paraqitur trillimet, gënjeshttrat, mashtrimet dhe fabrikimet e tij, duke e vënë në lajthim vetë GJPP.
84. Më tej, prokurori Rasim Maloku ka udhëhequr policinë në një lokacion të ndryshëm nga ai i përcaktuar me urdhëresën e Gjykatës Themelore në Ferizaj, UGJK nr. 70/23, dt. 12.07.2023.
85. Në fakt, lokacioni për kontroll/bastisje, i përcaktuar me urdhëresën e Gjykatës Themelore në Ferizaj, UGJK nr. 70/23, dt. 12.07.2023 ishte zyra ime e avokatisë, rruga Luan Haradinaj, ish rruga Brigadat e Kosovës, ku unë ushtroj profesionin, ndërsa kontrolli është zbatuar efektivisht në njëren nga pronat e mia që gjendet në Fshatin Ndërkombëtar, e cila fare nuk përcaktohej si objekt kontrolli në urdhëresën në fjalë.
86. Gjithashtu, edhe pse urdhëresa në fjalë parashikonte sekuestrimin e armëve pa leje, prokurori Rasim Maloku arbitrarisht tejkaloi edhe vetë urdhrat e GJPP, duke urdhëruar policinë që të sekuestronin sende përtej urdhëresës, përkatësisht armën time-revole, për të cilën kam leje posedimi dhe bartje me vete tash e sa e vjet, të lëshuar në mënyrë të rregullt dhe të ligjshme nga autoritetet kompetente.

### Petitumi:

**Për arsyet e lartpërmendura, marrë parasysh faktin se tashmë është provuar haptaziURREJTJA e prokurorit Rasim Maloku kundër meje është aq e thellë, e motivuar dhe aq e theksuar, sa që çdo veprim që i njëjti mund të ndërmarrë nuk do të jetë objektiv dhe i pavarur, marrë parasysh natyrën serioze dhe të rëndë të krimeve të denoncuara më lart, të kryera qëllimisht nga prokurori Rasim Maloku dhe faktin se unë nuk kam asnjë lidhje me asnjërin të pandehur në çështjen penale PP.I. nr. 58/23, me qëllim të sigurimit efektiv të një hetimi objektiv dhe të pavarur, me respekt kërkoj nga ju që si autoritet kompetent:**

- **TË THEMELONI një ekip prokurorësh, detyra e të cilëve të jetë vlerësimi dhe shqyrtimi i ligjshmërisë dhe kushtetutshmërisë së çdo veprimi procedural të marrë kundër meje nga prokurori Rasim Maloku, përkatësisht arrestimit tim, bastisjes dhe kërkesës për caktimin e paraburgimit;**
- **TË MERRNI nën juridiksionin e Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit çështjen penale PP/I. nr. 58/23 kundër meje;**



- **TË INICONI** procedurën hetimore kundër prokurorit Rasim Maloku, në drejtim të hetimit penal të keqpërdorimit të autorizimeve të tij zyrtare, përmes abuzimit me pushtetin prokurorial.

Me respekt e parashtruar nga,

Av. Besnik R. BERISHA



Prishtinë, më 20 korrik 2023